

**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**-kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani, kryetare, mr.sc.Muhamet Rexha dhe Erdogan Haxhibeqiri, anëtarë, në çështjen juridike të paditësit H. H. nga ..., të cilin e përfaqëson avokati A. K., nga ..., kundër të paditurës NT”E. T.”, nga ..., për kompensimin e dëmit, përkitazi me revizionin e paditësit, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës CA.nr.597/2014 datë 29.11.2016, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 29.06.2017, mori këtë:

### **A K T G J Y K I M**

REFUZOHET si i pabazuar revizioni i paditësit H.H., nga ...,paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, CA.nr.597/2014 datë 29.11.2016.

### **A r s y e t i m i**

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, CA.nr.597/2014 datë 29.11.2016, refuzohet si e pabazuar ankesa e paditësit, H. H., nga Prizreni dhe vërtetohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren, C.nr.967/2006 datë 17.04.2013, me të cilin në pjesën e I të dispozitivit, refuzohet si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit H. H., nga ..., për detyrimin e të paditurës NT”E. T.”, nga ..., që paditësit t’ia kompensimin e dëmit jo material dhe material të përshkruar si në dispozitiv të aktgjykimit të goditur.

Me pjesën II të dispozitivit, është vërtetuar se paditësi B. B., ka tërhequr padin dhe padia e paditësit H.H., nga ..., është tërhequr në raport me të paditurin e parë E.I.I. JRS me seli në S...të - ....

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë revizion me kohë ka paraqitur paditësi H. H., nga P., përmes të autorizuarit të tij, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës konstatimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që aktgjykimet e të dy gjykatave të prishen dhe lëndat t'i kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të aktgjykimit të goditur në bazë të dispozitës së nenit 215 të LPK, ka gjetur se:

Revizioni është i pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me datë 03.03.2005 në vendin Silver në afërsi të Stambollit, Turqi, ka ndodhur aksidenti i komunikacionit, ku paditësi në cilësinë e bashkudhëtarit në autobus ka marrë lëndime trupore. Autobusi sipas sigurimit ndërkombtarë ka qenë i siguruar në E.I.I., JRS me seli në ..., Rep. e .... Nuk është kontestuese fakti se paditësi mbi bazën e policës së sigurimit si dhe limitit të përcaktuar në vendin e ndodhjes së aksidentit ka realizuar kompensimin e dëmit për aksidentin e përjetuar në Biron Nacionale të Turqisë në shumë prej 50.000 TL. Sipas fletëpagesës NLB Bankë në Prishtinë, vërtetohet se paditësit i është bërë pagesa në lartsi prej 24.893,00 Euro, në emër të dëmit të përjetuar.

Gjykata e shkallës së parë pas administrimit të provave, ka refuzuar kërkespadinë e paditësit me arsyetim se në rastin konkret bëhet fjalë për aksidentin e komunikacionit me element të huaj dhe se për këtë arsye paditësi ka realizuar të drejtën në kompensimin e dëmit sipas nenit 3 të Konventës së Hagës mbi Ligjin e zbatueshëm për aksidentet e trafikut rrugor.

Gjykata e shkallës së dytë në procedurën e ankimit në tërësi ka pranuar si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin juridik dhe konstatimin faktik të gjykatës së shkallës së parë, andaj ka refuzuar në tërësi si të pabazuar ankesën e paditësit.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, ka gjetur se gjykata e shkallës së dytë duke vërtetuar drejt dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike, drejt ka zbatuar të drejtën materiale kur ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar. Aktgjykimi i goditur

nuk përmban shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, të cilat kjo gjykatë i vlerëson sipas detyrës zyrtare. Gjykata e shkallës së dytë në aktgjykimin e saj ka dhënë arsye të mjaftueshme për faktet relevante për gjykim të drejtë të kësaj çështje juridike të cilat i pranon edhe kjo Gjykatë.

Prandaj, të papranueshme janë thëniet në revizion se gjykatat e instancës më të ulët gabimisht kanë zbatuar të drejtën materiale kur kanë refuzuar kërkesëpadinë e paditësit pasi që sipas raportit të policisë ky aksidente i komunikacionit ka ndodhur me fajin ekskluziv të vozitësit të autobusit të paditurës i cili si rezultat i mospërshtatjes së shpejtësisë me kushtet dhe rrethanat e rrugës ka dalë jashtë rrugës dhe është prapsura dhe mbi këtë bazë e paditura ka përgjegjësi për kompensimin e dëmit .Këto pretendime të revizionit nuk mund të qëndrojnë për arsye se në rastin konkret nuk janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 173 të LMD-së, që e paditura NT”E. T.”, nga ...., të përgjigjet për dëmin e shkaktuar sipas parimit të përgjegjësisë objektive .E paditura e ka siguruar autometin e tij nga auto përgjegjësia dhe përjashtohet nga përgjegjësia objektive e paditurës si posedues i sendeve të rezikëshme.

Në fakte, paditësi ka realizuar të drejtën në kompensimin e dëmit në bazë të nenit 3 të Konventës së Hagës mbi Ligjin e zbatueshëm për aksidentet e trafikut rrugor, ku me këtë dispozitë është miratuar e drejta e përgjithshme kolezive sipas cilës në territorin ku ka ndodhur aksidenti zbatohet legjislacioni vendorë sipas principit “lex loci delicti commissi në lartësinë e shumës së siguruar . Andaj, me të drejtë të dy gjykatat kanë refuzuar kërkesëpadinë e paditësit duke gjetur se nuk janë plotësuar kushtet ligjore as në aspektin formal e as në aspektin material, për detyrimin e paditurës për kompensimin e dëmit paditësit dhe për këtë arsye pretendimet në revizion nuk e vejnë në dyshim ligjshmërinë e aktgjyimit të goditur ashtu si pa bazë theksohet në revizion.

Së këndejmi, Gjykata Supreme gjen se nuk mund të pranohen si të bazuara pretendimet në revizion për shkeljen thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par.2 pika (n) të LPK, për faktin se aktgjykimet e kundërshtuara nuk përfshihen me të meta të cilat këto aktgjykime i bëjnë të kundërligjshme, nga se dispozitivi dhe arsyetimi i tyre është i kuptueshëm dhe mbështet në prova të pranueshme edhe për këtë gjykatë të revizionit. Për më tepër, në arsyetimin e aktgjyimit janë dhënë arsye për të gjitha faktet relevante, të vlefshme për

gjykim të drejtë lidhur me kërkesëpadinë e paditësit, të cilat janë të pranueshme edhe për gjyktën e revizionit.

Nga sa u tha më sipër me zbatimin e nenit 222 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË

Rev.nr.117/2017 datë 29.06.2017

Kryetare e kolegjit,  
Gyltene Sylejmani